

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Mbushet sheshi “Skënderbeu”, me imazhin e Hashim Thaçit të stampuar në bluzë, Endriti i bashkohet pr otestës së tretë, të pranishëm dhe politikanë (DETAJE-FOTO)
ADRESA	https://newsbomb.al/rajon/mbushet-sheshi-skenderbeu-qindra-qytetare-behen-bashke-ne-dite-n-e-dyte-te--i401526
BURIMI	newsbomb.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	18 shtator 2026, 09:59:40 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	18 shtator 2026, 09:55:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	a5e3c349575fb1d230f1311fca4d594f414084e09a7963af1ca2a0502860a98c
TEKSTI	4bb0217649ac04afacd3ccd32433ade3675e81835eb1fc6ccbb9131d2b6a0a
PAMJA	490b8f85e749be158d07bf7aad6fc8244e70c786e71c4a7465d1882e1e12e44

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	ec7ed92b3376fb8a4957dbe166337b6e3c39e25e41c9c1f1eb07f4c92697eef8
E MËPARSHMJA	4261a267cbc4af1742d6186b401f33d32194266b99e5f3f760f92e9fa092de03
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/ec7ed92b3376fb8a4957dbe166337b6e3c39e25e41c9c1f1eb07f4c92697eef8

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

12 numrat e parë FALAS!
Version PDF

Abonohu te Revista

Kreu Politikë Aktualitet Ekonomi Kulturë & Art Rajon Sport Bota Showbiz SocialBomb



Çështjet kryesore

Haga vendos për katër ish-krerët e UÇK-së!

Arrestohet Ergys Agasi

"Retreat"-i i qeverisë në Pogradec!

Rajoni

18 Shtator 2026, 11:55

Mbushet sheshi "Skënderbeu", me imazhin e Hashim Thaçit të stampuar në bluzë, Endriti i bashkohet protestës së tretë, të pranishëm dhe politikanë (DETAJE-FOTO)

Shkruar nga Newsbomb



Politikanë të pranishëm në protestën në Prishtinë, i pranishëm dhe Endrit Thaçi

Kanë nisur grumbullimet e qytetarëve në sheshin "Skënderbeu" në Prishtinë, ku siç ishte dhe njoftuar më parë shqiptarë pritet të bëhen mesditën e sotme të gjithë bashkë në mbështetje të ish-krerëve të UÇK-së të cilët u dënuan në Hagë me 81 vite burg në total.

Teksa për pak minuta pritet që të mbahet protesta në zemër të Prishtinës, Ambasada Amerikane ka dalë me njoftim duke kërkuar shmangien e zonës në rast se mund të ketë tensione. Ndërsa mësohet se që në minutat e para të protestës sheshi është mbushur plot me qindra qytetarë dhe figura të njohura të politikës, në mesin e tyre Ramush Haradinaj, Time Kadriu, dhe përfaqësues të OVL-UÇK, të cilët me këngë patriotike dhe flamujt e UÇK-së në duar janë gati për turbimin e sotëm.

Ashtu siç dhe e njoftoi dje, në minutat e para të protestës në shesh ka mbërritur dhe djali i Hashim Thaçit, Endriti, i cili është shfaqur i veshur me një bluzë e cila është stampuar me imazhin e të atit dhe logon e UÇK-së.

Pamje nga grumbullimi i sotëm:



Revista



Abonohu tani dhe lexoje >

Lajmet e fundit



Aktualitet

Nga reporter i luftës në Kosovë, në parlamentin belg, deputeti i qendrës së majtë ndan foto-kujtimet e 1999 me parlamentaren e re




Aktualitet

Hyseni, Sadushi dhe Papajorgji, tre shqiptarët që po punojnë për Kongresin botëror të juristëve, do dekorohet presidenti Italian

Zbulo më shumë artikuj >





"Disa organizata të mëdha kanë njoftuar demonstrata të mëdha për të premten, më 18 shtator, në orën 12:00 në Sheshin Skënderbej. Këto demonstrata mund të shkaktojnë turma të mëdha, mbyllje rrugësh dhe ndërprerje të rënda të trafikut në zonat përreth. Për shkak të grumbullimeve të mëdha dhe ndërprerjeve të trafikut, ju lutemi shmangni Sheshin Skënderbej dhe zonat përreth gjatë kësaj kohe" shkruhet në njoftimin e bërë nga Ambasada.

Sakaq mësohet se masa të shumta policie ndodhen në terren, ndërsa deri më tani bëhet me dije se është bllokuar qarkullimi i makinave në rrugën "Luan Haradinaj".

Në lidhje me organizimin e tubimit të sotëm në mbështetje të krerëve të UÇK-së, Policia e Kosovës ka dalë me një komunikatë për mediat, përmes së cilës ka kërkuar që të mos hidhen sende apo mjete të forta, të mos përdoren maska dhe që protesta të zhvillohet në mënyrë të qetë e të sigurt.

"Me qëllim të garantimit të rendit e sigurisë publike, mbrojtjes së jetës dhe pronës si dhe ofrimit të sigurisë ndaj qytetarëve e pjesëmarrësve në protestë, Policia e Kosovës iu bën thirrje të gjithë pjesëmarrësve në çdo protestë që të respektojnë dispozitat ligjore dhe udhëzimet e zyrtarëve policorë, të tregojnë kujdes e maturi gjatë protestimit, të mos hedhin gjësende e mjete të forta, të mos përdorin maska dhe të kontribuojnë që protesta të zhvillohet në mënyrë të qetë dhe të sigurt" thuhet në komunikatën e lëshuar.

Tubimi i sotëm që po mbahet në zemër të Prishtinës përkon me ditën e tretë të protestës në mbështetje të ish-krerëve të UÇK-së, Hashim Thaçit, Jakup Krasniqit, Kadri Veselit dhe Rexhep Selimit.

Galeria fotografike ()



Sondazh

Poll

Lexo gjithashtu



🕒 E Premte 11:47

Paga më të larta në Malin e Zi, qeveria prezanton "Euro Model": Nga janari rroga minimale deri në 1400 euro



Rajoni

"Një dimër i vështirë na pret", bota drejt krizës, Mitsotakis kërkon ndërhyrje evropiane për çmimet e karburanteve



Rajoni

"Pa maska, me fytyrat tona", veteranët e UÇK-së protestojnë në Prishtinë pas vendimit të Hagës

🕒 E Premte 10:26



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.